

# RYKER: KOSOVA ËSHTË NË RRUGË TË MBARË TË FINALIZIMIT TË STATUSIT



Shefi i UNMIK-ut, Ryker në ceremoninë e shënimit të dyvjetorit të gjimnazit "Loyola" në veri të Prizrenit

Prizren, 16 prill

Në një atmosferë gazmore, në ambientet e gjimnazit "Loyola" në Prizren, u kremtua dyvjetori i themelimit. Ndërkohë atmosferës së gëzuar, madhështinë ia shtoi edhe ardhja e mysafirëve të shumtë, në mesin e të cilëve ishin edhe kryeadministratori i Kosovës, z. Joachim Ruecker, komandanti i KFOR-it, gjenerali Rolan Kather dhe shumë përfaqësues të subjekteve politike, ushtarake e fetare. Në këtë kontekst, pas referimit përshëndetës të nikoqirit të gjimnazit "Loyola Gimnasium" drejtorit Walter Happel, pos të tjerëve, këtë ceremonial e kanë përshëndetur edhe kryeadministratori Ruecker, i cili ka vënë në spikamë faktin se sot gjysma e strukturës së udhëheqjes së vendit po qëndron në Nju-Jork e gjysma tjetër në Prizren, ndërkohë që ka theksuar edhe të dhënë se Kosova aktualisht është në rrugë të mbarë drejt finalizimit të statusit të saj politik. Ai në fund ka vënë në spikamë edhe faktin se Kosova, me ceremonialin e sotëm, ka dëshmuar se është një vend i dëshirueshëm jo vetëm për të gjithë përfaqësuesit e nacionaliteteve, por banorët e këtushëm i karakterizon një tolerancë e jashtëzakonshme në aspektin fetar.

Kurse komandanti i KFOR-it, gjenerali Rolan Kather, duke i përshëndetur të pranishmit, ka shprehur optimizmin e tij për të ardhmen e sigurt të Kosovës, pasi që, sipas tij, më tepër se gjysma e banorëve të këtij vendi janë nën moshën 35-vjeçare. Sipas tij, KFOR-i edhe më tutje do të qëndrojë në dispozicion të mbrojtjes së popullatës e rrjedhimisht edhe të shkollarëve, të cilëve u ka uruar që me dituritë e

tyre të dërgojnë sinjale të mira nga Kosova drejt Evropës. Më pastaj ceremonialin e kanë bërë më të këndshëm edhe kori i fëmijëve, ai i nxënësve të rritur si dhe kori i prindërve dhe i arsimtarëve, të cilët për të pranishmit kanë ekzekutuar një mori pikash muzikore, nga opusi i krijimtarisë muzikore të autorëve shqiptarë e ndërkombëtarë.

Me këtë rast, do theksuar faktin se funksionimi i gjimnazit klasik "Loyola", i cili daton që nga 16 prilli i vitit 2005, paraqitet si një "infuzion" për tërë spektrin edukativ-arsimor në Kosovë, i cili, veçmas në vitet e tranzicionit, po lëngon nga të metat shumëdimensionale, ku procesi edukativ-arsimor zhvillohet në suazat e objekteve të këtij kompleksi. Shkolla në fjalë shtrihet në një sipërfaqe prej afro 4 hektarësh, të cilën ia ka lënë në dispozicion KK në Prizren qysh në vitin 2004. Pos objekteve shkollore, konviktit për vajza, atij për djem, terreneve sportive, ndodhet edhe një amfiteatër i hapur, ku nxënësit kanë mundësi për zhvillimin dhe shpërfaqjen e evenimenteve të ndryshme kulturore-artistike. Kurse në planet dhe programet e kësaj shkolle janë të përfshira të gjitha lëndët që mësohen në gjimnazet klasike të vendit, por këtu njëkohësisht mësohen edhe lëndët e gjuhës gjermane dhe asaj latine. Aktualisht në këtë shkollë mësimet i vijnë 318 nxënës, gjysma prej tyre të gjinisë femërore, të cilët vijnë nga të gjitha zonat e Kosovës. Ndërkohë që prindërit janë tejet të kënaqur me kushtet që ata i gëzojnë këtu, qoftë në aspektin e procesit mësimor a të sistemit dhe ushqimit të tyre.

Myrjet Shasivari